



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____. _____. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

Duke shprehur konsideratën për veprimtarinë e organizatës që ju drejtoni, në përgjigje të kërkesës tuaj, regjistruar me numër rendor 27, në regjistrin përkatës të kërkesave dhe përgjigjeve, si dhe me aktin nr. 4514/2 prot., datë 21.08.2023, , referuar ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, ju bëjmë me dije si më poshtë:

Z. {...}, në vitin 2019, i është nënshtruar provimit të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, duke u përfshirë në listën përfundimtare të renditjes së kandidatëve si një nga kandidatët fitues. Pas kësaj, ai i është nënshtruar verifikimit të pasurisë dhe figurës dhe në vijim Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me anë të **procesverbalit {...}** ka vendosur për paraqitjen dhe përfshirjen në rendin e ditës të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera dhe aktet lidhur me:

- shqyrtimin e projektvendimit për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar për kandidatin z. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të **vendimit nr. 250, datë 04.11.2019** ka vendosur kualifikimin e tij për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2019-2020.

Sa i përket procedurës së ndjekur të verifikimit dhe rezultateve të saj, ato parashtrohen hollësisht në vendimin e sipërcituar, që gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në linkun:

<http://klgj.al/wp-content/uploads/2021/08/VENDIM-Nr.250-dat%C3%AB-04.11.2019-P%C3%8BR-KUALIFIKIMIN-E-KANDIDATIT-Z.%E2%80%A6-P%C3%8BR-N%C3%8B-FORMIMIN-FILLESTAR-P%C3%8BR-MAGJISTRAT-PROFILI-GJYQATAR-N%C3%8B-SHKOLL%C3%8BN-E-MAGJISTRATUR%C3%8BS.pdf>

Referuar nenit 34 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, jo më vonë se në fund të muajit janar të çdo viti, Shkolla e Magjistraturës i dërgon Këshillit të Lartë Gjyqësor listën e kandidatëve për magjistrat, profili gjyqtar, që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës. Lidhur me këtë procedurë Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me anë të **procesverbalit**

{...} ka vendosur për paraqitjen dhe përfshirjen në rendin e ditës të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera dhe aktet lidhur me:

- shqyrtimin e projektvendimit “Për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që pritet të diplomohen në vitin akademik 2021-2022”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të vendimit **nr. 21, datë 17.01.2022** ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të rekrutimit si gjyqtar të kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, (në të cilën bën pjesë edhe z. {...}) që priteshin të diplomoheshin në vitin akademik 2021-2022.

Vendimi i sipërcituar gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në linkun:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/01/VENDIM-Nr.-21-Dat%c3%ab-17.01.2022-P%c3%8bR-FILLIMIN-E-PROCEDUR%c3%8bS-S%c3%8b-VERIFIKIMIT-T%c3%8b-KUSHTEVE-DHE-KRITEREVE-LIGJORE-T%c3%8b-REKRUTIMIT-SI-GJYQTAR-T%c3%8b-KANDIDAT%c3%8bVE-P%c3%8bR-MAGJISTRAT%c3%8b-PROFILI-GJYQTAR.pdf>

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me anë të **procesverbalit {...}** ka vendosur për paraqitjen dhe përfshirjen në rendin e ditës të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera dhe aktet lidhur me:

- shqyrtimin e projektvendimit “Për kualifikimin për emërim të kandidatit të diplomuar në Shkollën e Magistraturës, z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me anë të vendimit **nr. 290, datë 20.07.2022** ka vendosur kualifikimin për emërim të kandidatit z. {...}, i diplomuar për magistrat në Shkollën e Magistraturës në vitin akademik 2021 - 2022 dhe vijimin e procedurës së emërimit si gjyqtar.

Vendimi i sipërcituar gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në linkun:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/10/VENDIM-Nr.290dat%c3%ab-20.07.2022-P%c3%8bR-KUALIFIKIMIN-P%c3%8bR-EM%c3%8bRIM-T%c3%8b-KANDIDATIT-T%c3%8b-DIPLOMUAR-N%c3%8b-SHKOLLN-E-MAGJISTRATUR%c3%8bS-Z.%e2%80%a6.pdf>

Në vijim të kësaj procedure, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me anë të **procesverbalit nr. {...}** ka vendosur për paraqitjen dhe përfshirjen në rendin e ditës të Këshillit të Lartë Gjyqësor ndër të tjera dhe aktet lidhur me:

- shqyrtimin e projektvendimit “Për emërim gjyqtar të z. {...}”.

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi të emërojë gjyqtar z. {...}, me anë të vendimit **nr. 313, datë 20.07.2022** si dhe me vendimin **nr. 327, datë 22.07.2022**, ka vendosur që gjyqtari i emëruar z.

{...} të caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...}.

Vendimet i sipërcituara gjenden të publikuara në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor në linqet si më poshtë:

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/10/VENDIM-Nr.313Dat%c3%ab-20.07.2022-P%c3%8bR-EM%c3%8bRIMIN-GJYQTAR-T%c3%8b-Z.%e2%80%a6.pdf>

<https://klgj.al/wp-content/uploads/2022/10/VENDIM-Nr.327-dat%c3%ab-22.07.2022-P%c3%8bR-CAKTIMIN-N%c3%8b-POZICION-T%c3%8b-GJYQTARIT-T%c3%8b-EM%c3%8bRUAR-Z.%e2%80%a6.pdf>

Bashkëlidhur gjeni kopje të procesverbaleve të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës që i përkasin magjistratit z. {...}, me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm {...}, ndërsa vendimmarrjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor mund ti aksesoni në linqet siç ju kemi informuar edhe më sipër.

Ju faleminderit për bashkëpunimin!